



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2022

**V E N D I M**

**Nr. 80, datë 26/04/2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 60, datë 31.03.2021, e Fondacionit “Së Bashku”, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive, znj. S.L., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*” nga ana e Njesisë Administrative Gjepalaj.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në këtë ankesë, Fondacioni “Së Bashku” e bën me dije fillimisht KMD-në se që prej muajit dhjetor 2021, është duke zbatuar nismën “*Përmirësimi i zbatimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në zonat rurale në Bashkitë Durrës, Krujë dhe Shijak*”, në kontekstin e projektit “*Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri*”, që zhvillohet nga PNUD në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC). Nisma ka në fokus të saj fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara në zonat rurale të tre bashkive të sipërcituara dhe rritjen e informacionit në kuadër të mekanizmave mbrojtës që garantohen nga ndihma juridike falas për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër, nga takimet e zhvilluara me këta persona, është konstatuar se godina pranë së cilës ushtron funksionet e saj Njësia Administrative Gjepalaj nuk plotëson kushtet e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuar. Znj. S.L., Drejtore Ekzekutive e këtij Fondacioni shprehet se në takimin që ka patur me grupet vulnerabël të kësaj njësie administrative, e cila u zhvillua në oborrin e godinës së saj,

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

ka vënë re se kjo godine nuk plotëson kushtet e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuara. Znj. S.L. sqaron se në kushtet, kur edhe ajo vetë është person me aftësi të kufizuar, e kishte patur të pamundur për të patur akses në këtë godinë. Znj. S.L. ka dërguar bashkëlidhur ankesës së saj, foto të hyrjes së godinës së Njesisë Administrative Gjepalaj, ku janë të pranishme shkallë dhe dyer në përmasa jo sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Ajo thekson faktin se Njësia Administrative Gjepalaj ushtron funksionet e saj në një godinë dy katëshe dhe shërbimet apo kontaktet me stafin e njesisë duhet të realizohen në brendësi të saj, ndërkohë që aksesit fizik në të nuk ofron lehtësitë që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për personat me aftësi të kufizuar.

Në nenin 5, pika 1 dhe 2, gërma f), të ligjit nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar*” përcaktohet se jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare. Sipas parashikimit të kësaj dispozite, politikat shtetërore duhet të mbështetin personat me aftësi të kufizuara, që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës, ku ndër të tjera edhe në komunikim dhe informacion.

Në Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015, e Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*” dhe Vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, e Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”*” përcaktohet se në çdo ndërtim publik/privat, të vjetër ose të ri, duhet të merren masat që të garantohen standardet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e jetësës së pavarur.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 60, datë 31.03.2021, së Fondacionit “Së Bashku”, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive, znj. S.L., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

**B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>2</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Njesisë Administrative Gjepalaj dhe për dijeni Bashkisë Shijak e subjektit ankues, me shkresën nr. 548/1, datë 06.04.2022, ku kërkohej informacion, mbi çështjen e parashtruar në ankesë.

- Me anë të shkresës nr. 86/1, datë 13.04.2022, Njësia Administrative Gjepalaj e njoftoi Komisionerin se kjo njësi në bashkëpunim me Bashkinë Shijak, ka ndërmarrë masat e nevojshme për përshtatjen e godinës së saj, për të mundësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara. Sipas kësaj shkrese, ndërtesa e kësaj njësie administrative aktualisht ka 2 (dy) hyrje, njëra prej të cilave është vënë në përdorim të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë shkresë theksohet fakti se në këtë njësi administrative ka rëndësi shumë të madhe mbështetja e personave me aftësi të kufizuara. Njësia Administrative Gjepalaj ka dërguar bashkëlidhur shkresës së sipërcituar edhe foto të ndërtesës, ku reflektohen ndryshimet e pësuara në godinë, për të siguruar aksesueshmërinë fizike të saj për personat me aftësi të kufizuara.
- Në datën 19.04.2022, KMD e dërgoi elektronikisht me e-mail shkresën e sipërcituar të Njesisë Administrative Gjepalaj, në adresë të subjektit ankues, ku kërkoj informacion lidhur me sa më sipër.
- Znj. S.L., Drejtore Ekzekutive e Fondacionit “Së Bashku” i ktheu përgjigje KMD-së, nëpërmjet e-mailit të datës 20.04.2022, ku citohet: *Përgëzohem punën e bërë nga Bashkia Shijak në lidhje me garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara dhe masat e menjëhershme të marra prej saj. Sjellim në vëmendje se garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara nënkupton garantimin e aksesueshmërisë në infrastrukturë dhe në ofrimin e shërbimeve. Përgëzohem punën e Bashkisë Shijak në këtë rast dhe heqim dorë nga ankimi për shkak të plotësimit të kushteve.”*

Në këto kushte, Komisioneri gjykoj se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa. Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015

---

<sup>2</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”<sup>3</sup>, Komisioneri deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 60, datë 31.03.2021, së Fondacionit “Së Bashku”, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive, znj. S.L., për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha – Të mira e shërbime  
Shkak – aftësi e kufizuar  
Lloji i vendimit – arritje efektiviteti

---

<sup>3</sup> Neni 94/1, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”